



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 66

**Tiranë – E mërkurë, 15 prill 2020**

## PËRMBAJTJA

|                                                                        | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 290, datë 11.4.2020            | Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)..... 3641                                                                                                                                                                                                                  |
| Urdhër i ministrit të Financave dhe<br>Ekonomisë nr. 88, datë 3.4.2020 | “Për shpalljen e ndryshimeve të përkthimeve të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr.9 “Instrumentet Financiare”(SNRF 9), të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.39 “Instrumentet Financiare” (SNK 39), si dhe të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr.7 “Instrumentet Financiare” (SNRF 7)..... 3643 |
| Vendim i Komisionit të Ndihmës<br>Shtetërore nr. 96, datë 27.3.2020    | Autorizim i ndihmës shtetërore “COVID-19: skema mbështetëse në formën e grantit”..... 3649                                                                                                                                                                                                                                                |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë nr. 44, datë 18.3.2020      | Mbi disa ndryshime në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit..... 3651                                                                                                                                    |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë nr. 45, datë 18.3.2020      | Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., nr. 276, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 37, datë 18.3.2015..... 3652                                                                                                       |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë nr. 46, datë 20.3.2020      | Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., nr. 277, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 38, datë 18.3.2015..... 3653                                                                                                     |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë nr. 47, datë 20.3.2020      | Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin shkurt 2020..... 3655                                                                                                                                                                                                          |

**VENDIM****Nr. 290, datë 11.4.2020****PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË  
DHËNAVE SHTETËRORE TË  
SISTEMIT INFORMATIK TË  
PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR  
(SIPI/IPSIS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 7 e 8, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS). Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS) është sistemi kryesor për planifikimin, analizën, përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike, si dhe për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuar.

2. Ky vendim zbatohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme që marrin pjesë në hartimin e kuadrit të politikave publike afatgjata për Republikën e Shqipërisë.

3. Portofoli i Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar përbëhet nga modulet e mëposhtme:

a) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) Prioritetet qeveritare;

c) Dokumentet strategjike, ku përfshihen:

i. Strategjitë kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale;

ii. Programet e zhvillimit;

iii. Dokumenti i zhvillimit të politikës;

iv. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian;

v. Dokumenti i politikave prioritare;

vi. Planet e veprimit.

ç) Korniza e treguesve të performancës;

d) Programi vjetor ligjor i qeverisë;

dh) Masat kombëtare prioritare:

- Paketa Kombëtare e Projekteve Strategjike.

e) Kalendari i planifikimit të integruar;

ë) Analiza e treguesve;

f) Raportet e monitorimit;

g) Dokumentet e arkivuara.

4. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar ndërvepron me sistemet/platformat qeveritare të përmendura më poshtë:

a) Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (SIMF), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;

b) Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;

c) Sistemin Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;

ç) Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENKP), në administrim të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;

d) Sistemin e Arkivit të Akteve të Qendrës së Botimeve Zyrtare (Sistemi i QBZ) në administrim funksional të ministrisë përgjegjëse për botimet zyrtare;

dh) Bazën e të Dhënave Statistikore, në administrim të Institutit të Statistikave;

e) Platformën për të Dhëna të Hapura.

5. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar përmban të dhëna, që ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore konsiderohen të dhënat e krijuara në SIPI/IPSIS, që përfshijnë të dhënat mbi dokumentet strategjike kombëtare, prioritetet, programet dhe projektet qeveritare, të tilla si:

i. Versioni i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

ii. Kodi, emërtimi, struktura, përmbajtja e dokumenteve strategjike;

iii. Të dhënat për nivelet e kuadrit të politikave si shtyllat strategjike, objektivat strategjike, qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat e lidhura me to, referencë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe treguesit standardë të tjerë;

iv. Të dhënat për masat prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

v. Lidhja hierarkike dhe funksionale midis të gjitha niveleve të kuadrit të politikave të krijuar në SIPI/IPSIS, sipas nënndarjeve “iii” dhe “iv”, sa më sipër;

vi. Të dhënat e treguesve të performancës (të impaktit dhe rezultatit) dhe lidhja e tyre me çdo nivel të kuadrit të politikave;



vii. Lidhja e politikave, objektivave specifike dhe masave me programet buxhetore;

viii. Krijimi i listës së institucioneve që nuk ekzistojnë në sistemin SIFQ- kod, emërtim.

b) Të dhëna dytësore përfshijnë informacionin, si më poshtë vijon:

i. Të dhënat buxhetore mbi projektet e investimeve të buxhetit afatmesëm;

ii. Të dhënat buxhetore mbi produktet e planifikuara të buxhetit afatmesëm;

iii. Emërtimin dhe kodet e njësive të qeverisjes së përgjithshme;

iv. Listën e programeve buxhetore – kod, emërtim;

v. Klasifikimin buxhetor në nivel kapitulli dhe artikulli në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij;

vi. Lidhjen e produkteve me treguesit e performancës SIPI/IPSIS;

vii. Lidhjen e projekteve të investimeve me masat prioritare;

viii. Të dhënat për buxhetin faktik për projektet e investimeve;

ix. Të dhënat për buxhetin faktik për produktet në nivel artikulli ekonomik;

x. Të dhënat mbi komentet e marra nga konsultimi publik i dokumenteve strategjike;

xi. Të dhënat mbi aktet e hyrjes në fuqi të dokumenteve strategjike;

xii. Të dhënat mbi objektivat, produktet dhe treguesit e krijuar jashtë kuadrit të planifikuar strategjik.

6. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar shkëmben informacion me institucionet publike, sipas parashikimeve të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, lidhur me shërbimet që ofrohen në bazë të legjislacionit përkatës, nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.

7. Bazat e të dhënave shtetërore të institucioneve publike, nga të cilat SIPI/IPSIS merr të dhëna, janë, si më poshtë vijon:

a) Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF):

i. Të dhënat buxhetore mbi projektet e investimeve të buxhetit afatmesëm;

ii. Të dhënat buxhetore mbi produktet e planifikuara të buxhetit afatmesëm;

iii. Lista e programeve buxhetore – kod, emërtim;

iv. Klasifikimi buxhetor në nivel kapitulli dhe artikulli në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij;

v. Lidhja e produkteve me treguesit e performancës SIPI;

vi. Lidhja e projekteve të investimeve me masat prioritare;

vii. Të dhëna për buxhetin faktik për projektet e investimeve;

viii. Të dhëna për buxhetin faktik për produktet në nivel artikulli ekonomik;

ix. Të dhëna mbi objektivat, produktet dhe treguesit e krijuar jashtë kuadrit të planifikuar strategjik.

b) Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ):

- Emërtimi dhe kodet e njësive të qeverisjes së përgjithshme.

c) Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENKP):

- Të dhëna mbi komentet e marra nga konsultimi publik i dokumenteve strategjike.

ç) Sistemi i Arkivit të Akteve të Qendrës së Botimeve Zyrtare (Sistemi i QBZ):

- Të dhëna mbi aktet e hyrjes në fuqi të dokumenteve strategjike;

d) Baza e të Dhënave Statistikore:

- Të dhëna për vlerat aktuale të treguesve të performancës.

8. Bazat e të dhënave shtetërore të institucioneve publike, të të cilat SIPI/IPSIS jep të dhëna, janë, si më poshtë vijon:

a) Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF), që administrohet nga ministria përgjegjëse për financat:

i. Versioni i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

ii. Të dhëna lidhur me qëllimin e politikave të programeve buxhetore;

iii. Të dhëna lidhur me objektivat specifike të programeve buxhetore;

iv. Masat prioritare strategjike lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

v. Të dhëna për treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektivit specifik.



b) Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (SIMNH), që administrohet nga ministria përgjegjëse për financat:

i. Shtyllat dhe objektivat strategjike të SKZHI-së;

ii. Treguesit e SKZHI-së dhe të strategjive sektoriale;

iii. Masat prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

iv. Referenca me standardet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

9. Përbërësit e arkitekturës software dhe hardware të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

10. Institucioni administrues i sistemit SIPI/IPSIS është njësi përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri.

11. Dhënës të informacionit janë njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIPI/IPSIS.

12. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të SIPI/IPSIS është, si më poshtë vijon:

a) Administratorët e SIPI/IPSIS kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SIPI/IPSIS në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, procesin e hartimit, të menaxhimit dhe të monitorimit të dokumenteve strategjike;

b) Njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për të dhënat që regjistrojnë në SIPI/IPSIS;

c) Njësia përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri, e cila koordinon, udhëzon dhe monitoron përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike, ka të drejta administrative në SIPI/IPSIS në këto role:

i. Administrator;

ii. Raportues;

iii. Auditues;

iv. Lexues i informacionit.

13. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i sistemit dhe bazës të të dhënave të SIPI/IPSIS përcaktohen dhe miratohen me rregullore të brendshme të institucionit administrues, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

14. Dokumentet strategjike do të përgatiten paralelisht në sistemin SIPI/IPSIS dhe atë shkresor, deri në përfundim të rishikimit të tyre, për një periudhë kohore jo më shumë se një vit.

15. Ngarkohen njësi përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIPI/IPSIS, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

URDHER  
Nr. 88, datë 3.4.2020

**“PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE  
TË PËRKTHIMEVE TË STANDARDIT  
NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT  
FINANCIAR NR.9 “INSTRUMENTET  
FINANCIARE”(SNRF 9) TË STANDARDIT  
NDËRKOMBËTAR TË  
KONTABILITETIT NR. 39  
“INSTRUMENTET FINANCIARE”  
(SNK 39), SI DHE TË STANDARDIT  
NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT  
FINANCIAR NR.7 “INSTRUMENTET  
FINANCIARE” (SNRF 7)**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 17.7.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të përkthimeve të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr.9 “Instrumentet Financiare” (SNRF 9) të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.39 “Instrumentet Financiare” (SNK 39), si dhe të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr.7 “Instrumentet Financiare” (SNRF 7)

2. Të gjitha standardet e mësipërme do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas datës 1.1.2020.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
Anila Denaj

**Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark)**

Ndryshime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7

**Ndryshime të SNRF 9 Instrumentet Financiare**

Janë shtuar paragrafët 6.8.1–6.8.12 dhe 7.1.8. Një titull i ri është shtuar para paragrafit 6.8.1. Nëntituj të rinj janë shtuar para paragrafëve 6.8.4, 6.8.5, 6.8.6, 6.8.7 dhe 6.8.9. Për lehtësi në lexim, këta paragrafë nuk janë nënvizuar.

Është ndryshuar paragrafi 7.2.26. Në këtë paragraf është nënvizuar teksti i ri.

**Kapitulli 6 Kontabiliteti mbrojtës**

...

**6.8 Përfashtime të përkohshme nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës**

6.8.1 Njësia ekonomike zbaton paragrafët 6.8.4–6.8.12, si dhe paragrafët 7.1.8 dhe 7.2.26(d) tek të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse të prekura drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark). Këta paragrafë janë të zbatueshëm vetëm për marrëdhënie mbrojtëse të tilla. Një marrëdhënie mbrojtëse preket drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) vetëm nëse reforma sjell pasiguri rreth:

(a) normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) (të cilësuar sipas kontratës ose jo) të përcaktuar si rreziku i mbrojtur; dhe/ose

(b) kohës ose shumës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark)-të bazuar në flukset monetare të zërit të mbrojtur ose të instrumentit mbrojtës.

6.8.2 Me qëllim zbatimin e paragrafëve 6.8.4–6.8.12, termi ‘reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark)’ i referohet reformës së mbarë tregut të normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), duke përfshirë zëvendësimin e një norme interesi që shërben si standard krahasues (benchmark) me një normë alternative të tillë si ajo që rezulton nga rekomandimet e paraqitura në raportin e Korrikut 2014 ‘Reformimi i Normave Kryesore të Interesit që Shërbejnë si Standard Krahasues (benchmark)’ të Bordit të Stabilitetit Financiar<sup>1</sup>

6.8.3 Paragrafët 6.8.4–6.8.12 ofrojnë përfashtime vetëm për kërkesat e cilësuar në këto paragrafë. Njësia ekonomike vijon të zbatojë të gjitha kërkesat e tjera të kontabilitetit mbrojtës për marrëdhëniet mbrojtëse të prekura drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

**Kërkesa me probabilitet të lartë për mbrojtjen e flukseve të mjeteve monetare**

6.8.4 Me qëllim përcaktimin nëse një transaksion parashikues (ose një përbërës i tij) është shumë i mundshëm sipas kërkesave të paragrafit 6.3.3, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) mbi të cilën janë bazuar flukset e mjeteve monetare të mbrojtura (të cilësuar sipas kontratës ose jo) nuk ndryshon si pasojë e reformës.

**Riklasifikimi i shumës së akumuluar në rezervën mbrojtëse të fluksit monetar**

6.8.5 Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 6.5.12 me qëllim përcaktimin nëse flukset monetare të ardhshme të mbrojtura pritet të ndodhin, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) mbi të cilën janë bazuar flukset e mjeteve monetare të mbrojtura (të cilësuar sipas kontratës ose jo) nuk ndryshon si pasojë e reformës.

**Vlerësimi i marrëdhënies ekonomike midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës**

6.8.6 Për zbatimin e kërkesave në paragrafët 6.4.1(c) (i) dhe B6.4.4–B6.4.6, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) në të cilën bazohen flukset monetare të mbrojtura dhe/ose rreziku i mbrojtur (i cilësuar sipas kontratës ose jo), ose norma e

<sup>1</sup> Raporti, 'Reforming Major Interest Rate Benchmarks', është i disponueshëm në adresën [http://www.fsb.org/wp-content/uploads/r\\_140722.pdf](http://www.fsb.org/wp-content/uploads/r_140722.pdf).



interesit në të cilën bazohen flukset monetare të instrumentit mbrojtës nuk ndryshon si pasojë e reformës.

#### **Përcaktimi i përbërësit të një zëri si një zë i mbrojtur**

6.8.7 Përveçse kur zbatohet paragrafi 6.8.8, për mbrojtjen e një përbërësi që shërben si standard krahasues (benchmark) të rrezikut të normës së interesit jo të cilësuar në kontratë, njësia ekonomike zbaton kërkesën në paragrafët 6.3.7(a) dhe B6.3.8—që përbërësi rrezik të jetë i identifikueshëm veçmas—vetëm në fillim të marrëdhënies mbrojtëse.

6.8.8 Nëse njësia ekonomike, në përputhje me dokumentacionin e saj për mbrojtjen, rivë shpesh (dmth ndërpret dhe rifillon) një marrëdhënie mbrojtëse sepse instrumenti mbrojtës dhe zëri i mbrojtur ndryshojnë shpesh (dmth njësia ekonomike përdor një proces dinamik në të cilin si zërat e mbrojtur edhe instrumentet mbrojtës të përdorur për të menaxhuar atë ekspozim, nuk qëndrojnë gjatë të pandryshuar), njësia ekonomike zbaton kërkesën në paragrafët 6.3.7(a) dhe B6.3.8—që përbërësi rrezik është i identifikueshëm veçmas—vetëm kur fillimisht përcakton një zë të mbrojtur në atë marrëdhënie mbrojtëse. Një zë i mbrojtur i vlerësuar në kohën e përcaktimit fillestar të tij në marrëdhënien mbrojtëse, pavarësisht nëse ishte koha e fillimit të mbrojtjes apo më pas, nuk rivlerësohet në asnjë ripërcaktim të mëpasshëm të së njëjtës marrëdhënie mbrojtëse.

#### **Fundi i zbatimit**

6.8.9 Njësia ekonomike do të përfundojë zbatimin në prospektivë të paragrafit 6.8.4 ndaj një zëri të mbrojtur në momentin më të hershëm:

(a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe

(b) kur ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse, në të cilën merr pjesë zëri i mbrojtur.

6.8.10 Njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafit 6.8.5 në momentin më të hershëm:

(a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të ardhshme të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe

(b) kur e gjithë shuma e akumuluar e rezervës së flukseve monetare të mbrojtura të lidhura me atë marrëdhënie mbrojtëse të ndërprerë, riklasifikohet në fitim ose humbje.

6.8.11 Njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafit 6.8.6:

(a) ndaj një zëri të mbrojtur, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur ose kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe

(b) ndaj një instrumenti mbrojtës, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të instrumentit mbrojtës.

Nëse marrëdhënia mbrojtëse, në të cilën marrin pjesë zëri i mbrojtur dhe instrumenti mbrojtës, ndërpritet më herët se data e cilësuar në paragrafin 6.8.11(a) ose se data e cilësuar në paragrafin 6.8.11(b), njësia ekonomike do të përfundojë zbatimin në prospektivë të paragrafit 6.8.6 ndaj asaj marrëdhënieje mbrojtëse në atë datë ndërprerjeje.

6.8.12 Kur përcakton një grup zërash si zë të mbrojtur, ose një kombinim të instrumenteve financiarë si instrument mbrojtës, njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafëve 6.8.4–6.8.6 ndaj një zëri individual ose ndaj një instrumenti financiar në përputhje me paragrafët 6.8.9, 6.8.10, ose 6.8.11, sipas nevojës, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur dhe/ose



kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të atij zëri apo atij instrumenti financiar.

## **Kapitulli 7 Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare**

### **7.1 Data e hyrjes në fuqi**

...

7.1.8 *Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark)*, që ndryshoi SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7, i publikuar në Shtator 2019, shtoi Seksionin 6.8 dhe ndryshoi paragrafin 7.2.26. Njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2020 ose më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

### **7.2 Periudha kalimtare**

#### **Periudha kalimtare për kontabilitetin mbrojtës (Kapitulli 6)**

...

7.2.26 Si përjashtim për zbatimin në prospektivë të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi, njësia ekonomike:

...

(d) zbaton kërkesat në Seksionin 6.8 në mënyrë retrospektive. Ky zbatim në retrospektivë vlen vetëm për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë në fillim të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këto kërkesa ose që ishin përcaktuar pas kësaj, si dhe ndaj shumës së akumuluar në rezervën e flukseve monetare të mbrojtura që ekzistonte në fillim të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike fillimisht zbaton këto kërkesa.

## **Ndryshimet në SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja**

Janë shtuar paragrafët 102A–102N dhe 108G. Para paragrafit 102A shtohet një titull i ri. Para paragrafëve 102D, 102E, 102F, 102H dhe 102J janë shtuar nëntituj të rinj. Për lehtësi në lexim, këta paragrafë nuk janë nënvizuar.

### **Mbrojtja**

...

#### **Përjashtime të përkohshme nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës**

102A Një njësi ekonomike zbaton paragrafët 102D–102N dhe 108G ndaj të gjitha marrëdhënieve mbrojtëse të prekura drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark). Këta paragrafë janë të zbatueshëm vetëm për marrëdhënie mbrojtëse të tilla. Një marrëdhënie mbrojtëse preket drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) vetëm nëse reforma sjell pasiguri rreth:

(a) normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), (të cilësuar sipas kontratës ose jo) të përcaktuar si rreziku i mbrojtur; dhe/ose

(b) kohës ose shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur ose të instrumentit mbrojtës.

102B Me qëllim zbatimin e paragrafëve 102D–102N, termi ‘reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark)’ i referohet reformës së mbarë tregut të një norme interesi që shërben si standard krahasues (benchmark), duke përfshirë zëvendësimin e një norme interesi që shërben si standard krahasues (benchmark) me një normë alternative të tillë si ajo që rezulton nga rekomandimet e paraqitura në raportin e Korrikut 2014 ‘Reformimi i Normave Kryesore të Interesit që Shërbejnë si Standard Krahasues (Benchmark)’ të Bordit të Stabilitetit Financiar<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Raporti, 'Reforming Major Interest Rate Benchmarks', është i disponueshëm në adresën [http://www.fsb.org/wp-content/uploads/r\\_140722.pdf](http://www.fsb.org/wp-content/uploads/r_140722.pdf).



102C Paragrafët 102D–102N ofrojnë përjashtime vetëm për kërkesat e cilësuar në këta paragrafë. Njësia ekonomike do të vazhdojë të zbatojë të gjitha kërkesat e tjera të kontabilitetit mbrojtës për marrëdhëniet mbrojtëse të prekura drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

#### **Kërkesa me probabilitet më të lartë për flukset e mjeteve monetare të mbrojtura**

102D Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 88(c) që një transaksion i parashikuar të jetë shumë i mundshëm, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) mbi të cilën janë bazuar flukset e mjeteve monetare të mbrojtura (të cilësuar sipas kontratës ose jo) nuk ndryshon si pasojë e reformës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

#### **Riklasifikimi i fitimit ose humbjes së akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse**

102E Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 101(c) me qëllim përcaktimin nëse transaksioni i parashikuar nuk pritet më që të ndodhë, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) mbi të cilën janë bazuar flukset e mjeteve monetare të mbrojtura (të cilësuar sipas kontratës ose jo) nuk ndryshon si pasojë e reformës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

#### **Vlerësimi i efektivitetit**

102F Për zbatimin e kërkesave në paragrafët 88(b) dhe AG105(a), njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) në të cilën bazohen flukset monetare të mbrojtura dhe/ose rreziku i mbrojtur (i cilësuar sipas kontratës ose jo), ose norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) në të cilën bazohen flukset monetare të instrumentit mbrojtës nuk ndryshon si pasojë e reformës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

102G Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 88(e), njësia ekonomike nuk i kërket të ndërpresë një marrëdhënie mbrojtëse sepse rezultatet aktuale të mbrojtjes nuk plotësojnë kërkesat në paragrafin AG105( b). Për të shmangur çdo dyshim, njësia ekonomike zbaton kushtet e tjera në paragrafin 88, përfshirë vlerësimin në perspektivë të paragrafit 88(b), për të vlerësuar nëse duhet të ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse.

#### **Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur**

102H Përveçse kur zbatohet paragrafi 102I, për mbrojtjen e një pjese që shërben si standard krahasues (benchmark) të rrezikut të normës së interesit jo të cilësuar në kontratë, njësia ekonomike zbaton kërkesën në paragrafët 81 dhe AG99F—që pjesa e përcaktuar të jetë e identifikueshme veçmas—vetëm në fillim të marrëdhënies mbrojtëse.

102I Nëse një njësi ekonomike, në përputhje me dokumentacionin e saj për mbrojtjen, rivë shpesh (dmth ndërpret dhe rifillon) një marrëdhënie mbrojtëse sepse instrumenti mbrojtës dhe zëri i mbrojtur ndryshojnë shpesh (dmth njësia ekonomike përdor një proces dinamik në të cilin si zërat e mbrojtur edhe instrumentet mbrojtës të përdorur për të menaxhuar atë ekspozim, nuk qëndrojnë gjatë të pandryshuar), njësia ekonomike zbaton kërkesën në paragrafët 81 dhe AG99F—që pjesa e përcaktuar është e identifikueshme veçmas—vetëm kur fillimisht përcakton një zë të mbrojtur në atë marrëdhënie mbrojtëse. Një zë i mbrojtur i vlerësuar në kohën e përcaktimit fillestar të tij në marrëdhënien mbrojtëse, pavarësisht nëse ishte koha e fillimit të mbrojtjes apo më pas, nuk rivlerësohet në asnjë ripërcaktim të mëpasshëm të së njëjtës marrëdhënie mbrojtëse.

#### **Fundi i zbatimit**

102J Njësia ekonomike përfundon zbatimin në perspektivë të paragrafit 102D ndaj një zëri të mbrojtur në momentin më të hershëm:

(a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përse i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe



(b) kur ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse, në të cilën merr pjesë zëri i mbrojtur.

102K Njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafit 102E në momentin më të hershëm:

(a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të ardhshme të bazuara-në normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe

(b) kur e gjithë shuma e akumuluar e fitimit ose humbjes të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse të lidhura me atë marrëdhënie mbrojtëse të ndërprerë, riklasifikohet në fitim ose humbje.

102L Njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafit 102F:

(a) ndaj një zëri të mbrojtur, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur ose kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe

(b) ndaj një instrumenti mbrojtës, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të instrumentit mbrojtës.

Nëse marrëdhënia mbrojtëse, në të cilën marrin pjesë zëri i mbrojtur dhe instrumenti mbrojtës, ndërpritet më herët se data e cilësuar në paragrafin 102L(a) ose se data e cilësuar në paragrafin 102L(b), njësia ekonomike do të përfundojë zbatimin në prospektivë të paragrafit 102F ndaj asaj marrëdhënie mbrojtëse në atë datë ndërprerjeje.

102M Njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafit 102G ndaj një marrëdhënieje të mbrojtur në momentin më të hershëm:

(a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur si dhe kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur ose të instrumentit mbrojtës; dhe

(b) nëse ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse ndaj të cilës zbatohet përjashtimi.

102N Kur përcakton një grup zërash si zë të mbrojtur, ose një kombinim të instrumenteve financiarë si instrument mbrojtës, njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafëve 102D–102G ndaj një zëri individual ose ndaj një instrumenti financiar në përputhje me paragrafët 102J, 102K, 102L, ose 102M, si të rëndësishëm, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur si dhe/ose kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të atij zëri apo atij instrumenti financiar.

#### **Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare**

...

108G *Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark)*, që ndryshoi SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7, i publikuar në Shtator 2019, shtoi paragrafët 102A–102N. Njësia ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2020 ose më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime në mënyrë retrospektive për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë në fillim të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këto kërkesa ose ishte caktuar pas kësaj, si dhe ndaj fitimit ose humbjes së njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që ekzistonte në fillim të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike fillimisht zbaton këto ndryshime.



## Ndryshime në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënie e Informacioneve Shpjeguese

Janë shtuar paragrafët 24H dhe 44DE–44DF si dhe është shtuar një nëntitull para paragrafit 24H. Për lehtësi në lexim, këta paragrafë nuk janë nënvizuar.

### Kontabiliteti mbrojtës

...

*Pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark)*

24H Për marrëdhëniet mbrojtëse për të cilat njësia ekonomike zbaton përjashtimet e paraqitura në paragrafët 6.8.4–6.8.12 të SNRF 9 ose paragrafët 102D–102N të SNK 39, ajo do të paraqesë informacion shpjegues:

(a) për normat e rëndësishme të interesit që shërbejnë si standard krahasues (benchmark) ndaj të cilave janë të ekspozuara marrëdhëniet mbrojtëse të njësisë ekonomike;

(b) për madhësinë e rrezikut të ekspozimit të menaxhuar nga njësia ekonomike që preket drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark);

(c) sesi njësia ekonomike menaxhon procesin kalimtar tek normat alternative që shërbejnë si standard krahasues (benchmark);

(d) përshkruet mbi supozimet ose gjykimet kryesore të bëra nga njësia ekonomike gjatë zbatimit të këtyre paragrafëve (për shembull supozime ose gjykime nëse pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues [benchmark]); dhe

(e) për vlerën nominale të instrumenteve mbrojtës në ato marrëdhënie mbrojtëse.

### Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

44DE *Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark)*, që ndryshoi SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7, i publikuar në Shtator 2019, shtoi paragrafët 24H dhe 44DF. Njësia ekonomike zbaton këto ndryshime kur zbaton ndryshimet në SNRF 9 ose SNK 39.

44DF Në periudhën e parë raportuese në të cilën njësia ekonomike zbaton *Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark)*, të publikuar në Shtator 2019, nuk kërkohet që njësia të paraqesë informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet.

## VENDIM

Nr. 96, datë 27.3.2020

### AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “COVID-19: SKEMA MBËSHTETËSE NË FORMËN E GRANTIT”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila Denaj kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Etleva Haka anëtare;
- Znj. Mirjana Zisi anëtare.
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;

në mbledhjen e datës 27.3.2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i

ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së mbështetjes të ndërmarrjeve dhe individëve në kushtet e situatës së përhapjes së COVID-19.

**Objektivi i skemës së ndihmës:** Skema synon të japë ndihmë në formën e granteve të drejtpërdrejta, për të përballuar dëmin e shkaktuar ndërmarrjeve, të ndikuara nga përhapja e virusit COVID-19 dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarisë ekonomike gjatë dhe pas përhapjes së COVID-19 si dhe individëve.

**Baza ligjore e skemës:** Draftvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masën e



përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”.

Komisioni shqyrtoi këtë masë me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë e skemës së sipërcituar me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar dhe:

#### VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës: Përfitues janë ndërmarrjet (çdo person fizik ose juridik privat), me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë, që kryejnë veprimtari ekonomike në të gjithë sektorët e ekonomisë si edhe individët, ndihma për të cilët jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

2. Vlera e ndihmës shtetërore: Ndhma do të jepet në formën e grantit të miratuar në buxhetin e shtetit, për vitin 2020, me vlerë të përgjithshme 5 850 000 000 (pesë miliard e tetëqind e pesëdhjetë milion) lekë.

3. Kohëzgjatja e ndihmës shtetërore: Ndhma do të jepet nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë nga COVID-19, por jo më shumë se 3(tre) muaj.

4. Administrimi i masës: Ministri i Shtetit për Rindërtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjensia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) dhe Shërbimi Social Shtetëror janë përgjegjës për administrimin e masës.

5. Shtrirja sektoriale dhe rajonale e masës: Masa është e hapur për të gjithë sektorët, përveç institucioneve financiare dhe ndërmarrjeve publike. Masa jepet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Elementet kryesorë të ndihmës:

1. Ndhmë financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milion) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, sipas urdhërave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

2. Një pagesë shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike;

3. Një pagesë shtesë për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

7. Ekzistenca e ndihmës shtetërore: Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Ndhma jepet nga buxheti i shtetit në kuptim të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” i ndryshuar.

- Skema është selektive, sepse ndihma i jepet vetëm ndërmarrjeve të caktuara të regjistruara në QKB, me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milion) lekë.

- Skema do të zbatohet në sektorë dhe ndërmarrje përfituese, të cilët janë aktivë në sektorët në të cilët ekziston tregtia ndërkombëtare.

Sa më lart, Komisioni i Ndhmës Shtetërore në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar vlerëson se:

- skema mbështetëse me grant për ndërmarrjet me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milion) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, përfshihet në rastet e parashikuara ndryshe në këtë ligj, dhe përbën ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës b), të nenit 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, e cila jepet për të mënjeluar gjendje të rënda në ekonominë e vendit të shkaktuar nga COVID-19.

- skema mbështetëse me grant nga buxheti i shtetit, nëpërmjet dhënies së një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike si edhe një pagesë shtesë për individët që përfitojnë pagesë për të ardhurat nga papunësia, përfshihet në rastet e parashikuara ndryshe në këtë ligj, dhe përbën ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës b), të nenit 7, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, e cila do të jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të shkronjës b) të nenit 7, shkronjës b) të nenit 13, shkronja a), të nenit 17, nenit 22, 30 dhe 31 të ligjit



nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në draftvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milion leke, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”, sepse ndihma jepet për të mënjeluar gjendjen e rëndë në ekonominë e vendit si dhe për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, e shkaktuar nga COVID-19.

2. Ndihma shtetërore t'i jepet ndërmarrjeve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të cilat nuk janë në vështirësi (sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar), deri më 31 dhjetor 2019, dhe ndërmarrjeve që nuk kanë hyrë në vështirësi më 31 dhjetor 2019, por që kanë hasur vështirësi ose kanë hyrë në vështirësi pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik dhe marrëdhënieve të punës, si rezultat i i gjendjes së epidemisë nga COVID-19.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të publikojë informacionin në lidhje me ndihmën e dhënë, në bazë të këtij vendimi, në faqen zyrtare brenda 12 muajve nga momenti i dhënies dhe të raportojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në zbatim të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve brenda datës 31 mars të vitit pasardhës të raportojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Anila Denaj

VENDIM  
Nr. 44, datë 18.3.2020

**MBI DISA NDRYSHIME NË  
MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E  
SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET  
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE)  
SH.A. DHE FURNIZUESIT**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, nr.37.6 Prot, datë 4.3.2020,”Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes të energjisë elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr 24, datë 15.2.2017 dhe nr. 58, datë 15.4.2019, ka vendosur të miratojë marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) sh.a., dhe furnizuesit.

- OSSH sh.a. me shkresën e saj nr. 439 Prot, datë 14.2.2020, ka dërguar kërkesën për miratimin nga ERE të ndryshimit të palës përgjegjëse për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga OSHEE në OSSH në marrëveshjen sipërcituar.

- Referuar nenit 72, të Ligjit nr. 45/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përcaktohet se, “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018, vendosi të bëjë transferimin e licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të OSHEE sh.a., me nr. 250, seria P14SH, miratuar nga ERE me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i



Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., me afat vlefshmerie deri më datë 27.10.2044.

- OSSH sh.a si person juridik, është përgjegjës për operimin e sigurt dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë.

- Bordi i ERE-s në shqyrtim të kërkesës së Shoqërisë OSHEE sh.a me vendimin, nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi periudhën tranzitore prej 12 muaj, për bërjen efektive të transferimit të licencave

- Në vijim, me vendimin nr. 146, datë 18.12.2019, vendosi të miratojë kërkesën e shoqërisë për shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, me qëllim bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" sh.a., (OSHEE sh.a.), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., dhe licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a.

- Si rezultat i ndarjes së Shoqërisë OSHEE sh.a., si dhe i vendimeve të sipërcituara, në zbatim të urdhrit nr. 157, data 12.2.2018 të Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, Shoqëria "OSSH" sh.a., prej janarit 2020 vijon operimin në treg, si operator i veçantë, ndërkohë që edhe ligjërisht, përcaktohet tashmë si person juridik përgjegjës për veprimtaritë e kryera deri më sot nga kjo strukturë, pjesë e organizimit të OSHEE GROUP sh.a., dhe se të gjithë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga Marrëveshja e Sigurimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike i kalojnë Shoqërisë OSSH sh.a.

- Me transferimin e licencës së aktivitetit të shpërndarjes shoqëria OSSH ka mbartur të gjithë të drejtat dhe detyrimet e operatorit të shpërndarjes në kuptim të aktivitetit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

- Ndryshimi në këtë Marrëveshje, lidhet vetëm me zëvendësimin e palës përgjegjëse për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes dhe nuk modifikon apo tjetëron të drejta e detyrime të parashikuara në të për palët.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në *Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes të energjisë elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Furnizuesit*, si në vijim:

a) Kudo në marrëveshje, fjala shoqëria "OSHEE" sh.a., do të zëvendësohet me fjalën Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

VENDIM  
Nr. 45, datë 18.3.2020

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË "ALBANIAN ENERGY  
SUPPLIER" SH.P.K., NR. 276, SERIA T15,  
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË, TË MIRATUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 37,  
DATË 18.3.2015.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma "d" të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma "e"; nenit 5, pika 1 gërma "e"; nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s nr.109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.40/4 Prot, datë 10.3.2020, të



përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 18, datë 31.1.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/6 prot datë 1.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Regullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 38/2 Prot., datë 4.2.2020, ERE-s iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 38/3 Prot, datë 18.2.2020, shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e munguar

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 276, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 37, datë 18.3.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 18.3.2020.

- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

Aplikimi i shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Regulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., me nr. 276, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 37, datë 18.3.2015, duke filluar vlefshmerinë e saj nga data 19.3.2020 për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 46, datë 18.3.2020**

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË**  
**SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY**  
**SUPPLIER” SH.P.K., NR. 277, SERIA**  
**FK15, NË VEPRIMTARINË E**  
**FURNIZIMIT TË ENERGJISË, TË**  
**MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT**  
**TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 38,**  
**DATË 18.3.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5 pika 1 gërma “d”, nenit 13 dhe



nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 e ndryshuar dhe nenit 15 të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licensimit, Mbikqyrjes dhe Autorizimeve, me nr.40/3 Prot., datë 9.3.2020, lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 31.1.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/5 Prot, datë 1.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 38/2 Prot., datë 4.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 38/3 Prot, datë 18.2.2020, shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Nga analiza që i'u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në bazë të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, e ndryshuar, rezulton si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, pika 4.7.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., me nr. 277, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 38, datë 18.3.2015, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 19.3.2020 për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



**VENDIM**  
**Nr. 47, datë 20.3.2020**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2020**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 20.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e datës 17.3.2020, si dhe relacionin shtesë, të datë 19.3.2020 për gatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin shkurt 2020,

Konstatoi se:

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 2877 Prot., datë 9.3.2020 dhe me anë të emailit të datës 19.3.2020 ka paraqitur e në vijim plotësuar, aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shkurt 2020.

- Nisur nga deklaratimet e FSHU sh.a., analizës së të dhënave në këtë aplikim në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë nga tregu i parregulluar, si dhe kurseve zyrtare të këmbimit bazuar nga publikimet e Bankës së Shqipërisë, ka rezultuar çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për muajin shkurt 2020 prej 6.269 lek/kWh.

- Në analizën e dokumentacionit të aplikimit që shoqëria FSHU sh.a., ka depozituar në ERE,

evidentohet se për përcaktimin e Kostove Administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, aplikuesi i ka vlerësuar si vijon:

|                        |               |
|------------------------|---------------|
| Shpenzime Operative    | 0.54 lekë/kWh |
| Kosto e Borxhit të keq | 0.66 lekë/kWh |
| Kompensimi për Humbjet | 0.59 lekë/kWh |

**Kosto Administrative Gjithsej 1.79 lekë/kWh -**

FSHU sh.a., deklaroi se për llogaritjen e çmimit FMF gjatë vitit 2019 është përdorur metoda e llogaritjes së kostove administrative për njësi të shitur për kWh, dhe meqenëse ERE nuk është shprehur ende me vendim bazuar në aplikimin e paraqitur nga FSHU sh.a., për çmimet e shitjes të energjisë elektrike me pakicë për vitin 2020, FSHU sh.a., propozon që përllogaritjet lidhur me Kostot Administrative të vitit 2019 të aplikohen edhe për muajt e parë të vitit 2020.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019 të bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.

- Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë lekë/euro të ditëve kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin shkurt 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon.



## Çmimi i FMF-së për muajin Shkurt 2020

| Shkurt 2020                                        |                                                                                                    | Aplikimi<br>FSHU sh.a. | Propozimi i<br>ERE |
|----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|--------------------|
|                                                    |                                                                                                    | Njësia                 | Çmimi              |
| CBEt                                               | Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi | Leke/kWh               | 6.269              |
| Pr                                                 | <u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>                                  | <u>Leke/kWh</u>        | <u>0.19</u>        |
|                                                    | Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante                                                     | Leke/kWh               | 6.46               |
| CA                                                 | Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit                                         | Leke/kWh               | 1.79               |
| TRr                                                | Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit                                                     | Leke/kWh               | 0.75               |
| TSHt                                               | Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes                                                     | Leke/kWh               | 1.50               |
| Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRrTSHt + CA |                                                                                                    | Leke/kWh               | 10.50              |

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezultojnë që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2020 të jetë **10.50 lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

## VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 10.50 lekë/kWh për muajin shkurt 2020.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrît Ahmeti

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë